

Besimtari

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti III i botimit, Qershor 2009 Nr. 26. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj

TURQIA SOT ESHTË KALIFATI POLITIK I TE GJITHE MUSLIMANEVE

Konspiracioni nderkombetar kunder botes islame eshte nje dukuri i cili eshte shume i lexueshem jo vetem ne mediat nderkombetare dhe ata kombetare, por eshte nje dukuri konkrete qe i ngjason nje rrjete qe kerkon te zere mbrenda te gjithe boten islame, ku plani me i afert i saj eshte qe bota islame te goditet me arme dhe me "demokraci" dhe me pas, pasi te kete mbaruar pune "tanku" dhe "demokracia" muslimaneve do t'u mungoje koha per te praktikuar fene islame. Vatrata e zjarrit nuk po shuhet, por po shtohen ne hapësirat muslimane. Perpjekjet per "modernizim" dhe degjenerim ne boten islame po intensifikohen, duke te krijuar idene se armiqte e botes islame thuhetse e kane fituar betejën me islamin. Por, qendrimi politik publik i Turqise per probleme madhore ne mbrojtje te botes islame ka bere qe bota islame te kuptoje se ajo e ka sot nje qender politike qe i mbron interesat e saj perballë perpjekjeve qe bejne qendra dhe forca te tjera te rrezikshme antiislame per te denigruar muslimanet dhe fene e tyre hyjnore. Dhe kjo qender nuk eshte nje shoqate, ose nje grup shoqatash, por eshte nje shtet me potence kolosale politike ekonomike dhe fetare i cili nuk mund te anashkalohet, sepse ai tashme ka te gjitha parametrat qe t'u imponohet edhe "Me te medhenjve" me qendrimin e tij qe ka te beje me problemet dhe fatin e botes islame. Ky shtet, te cilin ne nje numur te saj gazeta "Besimtari" e ka quajtur rreze drite per boten islame, eshte Turqia qe nga momenti ne moment po afirmohet si Kalifati Politik i muslimaneve. Kur Gaza ra viktime e sulmeve te ushtrise izraelite qe vrau



civile te pafajshem, ku shumica e viktimave ishin femije, qeveria e Turqise, permes kryeministrit, Taip Rexhep Erdogan i dha nje pergjigje te ashper presidentit izraelit, Peres ne Davos te Zvicres, duke i quajtur izraelitet vrases dhe shtetin e izraelit shtet vrases. Ishte i vetmi shtet qe reagoi pa doreza dhe pa hezituat ne berjen e nje portreti te tille kaq publik per vrasesit e palestinezëve ne Gaza. Dhe te mos harrojme se lidhjet politike dhe historike te Turqise me Izraelin jane te fuqishme, pa harruar se shume te fuqishme jane edhe lidhjet ushtarake ne mes te ketyre dy shteteve. Por, qeveria turke dhe stafi qe e drejton sot e kane percaktuar idene se interesat e muslimaneve ne Turqi dhe me gjere jane me jetike se interesat politike, ekonomike, dhe ushtarake te Turqise. Prandaj, kryeministri Erdogan e braktisi samitin e Davosit qe nuk arriti te denoje

ata qe vrane civile te pafajshem. Qendrimi i Turqise ne mbrojtje te botes islame u rrit ne nje shkalle edhe me te larte, kur ajo nuk ishte e gatshme te votonte sekretarin e ri te Natos, ish-kryeministri e Danikarkes, Rasmundsen, te cilin e akuzoi si armik te botes islame, pasi ne krizen ekarikatorave kunder profetit Muhamedit a.s., Rasmundsen e kishte quajtur te drejte botimin e karikatorave ne emer te lirise se shtypit, qe ishte ne fakt pjese e planin te forcave antiislame ne shkalle boterore. Kur u pranua, qe z\ vendesi i Rasmundsenit te ishte nje figure politike turke, u arrit te kalohej kriza me te cilin Nato perballohej per here te pare. Vizita e presidentit amerikan ne Turqi konfirmoi idene se edhe Bota Perendimore e njeh tashme Turqine si qendra politike e cila duhet pyetur per problemet qe kane lidhje me boten islame. Obama e quajti Turq-

ine nje ndermjetes percaktues per te normalizuar mardhenjet me boten islame. Por, eshte per te ardhur keq, kur politika shqiptare e perdor fushaten elektorale per te penalizuar Perendorine Osmane e cila eshte krenaria historike e popullit turk. Por, politika shqiptare nuk duhet te harroje se historia komuniste per Skenderbeun eshte nje mashtrim i madh qe vazhdon t'u behet shqiptareve, si pjese e politikës antiislame dhe se e verteta per figuren e Skenderbeut, nga e cila tremben historianet shqiptare dhe te huaj, eshte vetem ne arkivat e Turqise, i kesaj Turqie qe sot eshte Kalifati politik i muslimaneve per t'u bere, ne menyre te padiskutueshme, ne nje te ardhme jo te larget edhe kalifati fetar i Botes Islame

Selim Gokaj

VENDET ARABE SHQIPERIA DHE KOSOVA

Shqiaret dhe opinjoni publik nderkombetar sapo kane perkujtuar 10 vjetorin e sulmeve te Natos kunder Serbise, qe u pasuan me largimin e trupave ushtarake serbe nga Kosova duke sjelle premisen per shpalljen e Pavaresise se Kosoves, pavaresi qe sot populli i Kosoves e gezon. Pikerisht ne kete 10 vjetor te rendesishem, ne kujtojmë edhe ndihmen e madhe qe erdhi per popullin e Kosoves nga miqte e tyre arabe, te cilet dhane nje ndihme ekonomike dhe financiare qe arrin ne miliona dollare. Vetem nga prilli i vitit 1999, deri ne qershor 1999, ne aeroportin e Rinasit jane ulur 57 avione me ndihma nga vendet arabe per popullin e Kosoves. Jane 52 milion dollare ndihma humanitare per kosovaret, ku perqindja me e madhe e ketyre ndihmave eshte dhene nga Arabia Saudite. Sot, per fat te keq, ka nje qendrim indiferent nga vendet arabe per njohjen e Pavaresise se Kosoves e cila ka lidhje me qendrimin sektar dhe jo korrek te Shqiperise ndaj vendeve arabe qe po kap nje hark kohor thuajse 20 vjecar. Politika shqiptare, si nga e majta ,ashtu edhe nga e djathta nuk ka punuar per te ruajtur traditen e bashkepunimit tradicional ekonomike dhe kulturor me popujt arabe, ne nje kohe qe mbi 90% e vendeve arabe kane lidhje te fuqishme politike dhe ekonomike me SHBA, Angline , Gjermanine dhe vende te tjera perendimore. Nuk eshte e qarte perse politika shqiptare nuk rrit bashkepunimin me vendet arabe, ne nje kohe qe te tjeret perpiqen te krijojne ura bashkepunimi me keto vende. Sot, Evropa bashkepunon me vendet arabe per naften, gazin dhe ujin e pishem, ne nje kohe kur politika shqiptare i largohet ketij bashkepunimi per te cilin e ka terrenin te shtruar ,sepse ne cdo vend arab mund te takosh emrin e nje shqiptari qe ka punuar per ate vend ne periudha te ndryshme historike, sidomos nga shekulli i XV dhe ne vazhdim. Sot, vendet arabe jane nje potence e fuqishme financiare qe zoteron 36.5% te bankave boterore dhe ka nje prodhim industrial qe kap shifren 402 miliard dollare ne vit. Politika shqiptare duhet te bashkepujojte sot me kryeqytete te tilla arabe si: Kajro, Riad, Tripoli,



Dubai qe jane qendra te politikës dhe e konomise boterore. Politika shqiptare po kerkon voten e vendeve arabe per Kosoven, ne nje kohe qe nuk ka dhene mesazhe te qarta dhe te sinqerta bashkepunimi me Ligen Arabe dhe Konferencen e Vendeve Islamike. Sot, kur bota po jeton krizen e rende financiare, Shqiperia duhet te bashkepujojte me vendet arabe dhe bankat arabe, sepse ato jane pak te prekura nga kjo krize. Edhe udheheqja e sotme shtetore ne Kosove duhet te jete me aktive ne bashkepunimin me vendet arabe qe te jape garanci per nje miqesi te sinqerte dhe jo vetem pragmatike me arabet. Kosova duhet te jete pjese e ringjalljes se miqesise dhe te bashkepunimit me boten arabet qe kerkesa e saj per ta njohur keto vende mos te bjere ne nje vesh te shurdhet. Roli i SHBA eshte vendimtar ne arrijten e Pavaresise se Kosoves. Por, nuk duhet lene ne heshtje edhe ndihma e botes arabe per Kosoven qe ishte ekonomike dhe politike, e gatshme te ishte edhe ushtarake. Keto fakte, politika shqiptare dhe kosovare, duhet t'i beje te ditura qe vota per njohjen e Kosoves te jete sa me e rrezatuar nga vendet arabe. Te mos harrojme se kjo situatë e nderlikuar ne mosnjohjen e Pavaresise se Kosoves ka sjelle aktivizimin e aleancave te vjetra nacionaliste

– ortodokse kunder shqiptareve, ku spikat trekendeshi Athine – Moske- Beograd, me nje strategji dhe politike te rrezikshme per te sabotuar ne arenen nderkombetare njohjen e Pavaresise se Kosoves. Mund te duket e habitshme, por Rusia eshte pjesemarrrese e rregullt e Konferencës se Vendeve Islamike me statusin e vezhguesit, ne nje kohe qe Shqiperia ka marre poziten e nje shteti indiferent ne kete Konferencë, e shoqeruar kjo edhe me nje stuhi te eger mediatike antimuslimane, media, qe sot penalizojne boten arabe qe nuk po e njeh Pavaresine e Kosoves. Eshte fatkeqesi qe ne Shqiperi kane ambasada vetem 4 vende arabe te cilat jane; Arabia Saudite, Egjipti, Libia dhe Palestina. Veprimtaria e shume e varfer e jetes diplomatike e ketyre vendeve tregon realitetin e hidhur te nivelit te mardhenjeve te Shqiperise me vendet arabe.

Shoqata e Miqesise, Shqiperi – Vendet Arabe, qe eshte krijuar ne janar 2000, mori nxitje nga ndihma bujare e botes arabe per Kosoven. Shoqata ka propoganduar fuqishem se shqiaret jane 7,4 milion banore dhe jetojne ne trojet e tyre dhe kane lidhje miqesie shekullore me popujt arabe dhe jane pikerisht shqiaret ne Ballkan qe do t'i japin mundesi kesaj miqesie qe te ece me perpara. Duhet qe te

jete politike e dites bashkepunimi i Tiranes dhe i Prishtines zyrtare me boten arabe, sepse na lidh tradita dhe religjoni i shumices me boten arabe, pa perjashtuar edhe bashkepunimin me Perendimin. Nje filozof i njohur pohon se jane popujt ata qe krijojne miqesine ne mes te tyre, por qe kjo miqesi mund te cenohet nga politikate qeveritare. Mbetet detyre e Liges Arabe qe te nxise vendet arabe per te njohur pavaresine e Kosoves, pavaresisht nga qendrimi i politikës shqiptare ndaj botes arabe, sepse ky eshte qendrim i politikës dhe jo i shqiareve te cilet ushqejne nje respekt dhe dashuri te vecante per boten arabe qe ka ndihmuar popullin boshnjak dhe kosovaret te cilet rane viktimat e genocidit serb. Ne pershendesim me respekt stacionet televizive te fuqishme te botes arabe si: Al- Xhazira dhe Al- Arabia qe i bejne jehone ngjarjeve te viteve te luftes ne Kosove dhe situatave te ndryshme qe po kalon sot Kosova, duke mbajtur gjalle urat e miqesise ne mes te popullit shqiptar dhe popujve arabe.

Muhamer Vuci

Sekretar i Shoqates se Miqesise
Shqiperi-Vendet Arabe

ISLAMI DHE MUSLIMANET NE FOKUSIN E NJE BESIMTARI

Duke jetuar në Shqipëri, duke u përballur çdo ditë me sfidat e mundimit, duke u munduar që të jesh aktiv dhe të punosh, të lexosh, të humltohesh e në fund të nxjerrësh konkluzione, kupton realitetin me të cilin ti përballësh çdo ditë. I mirë apo i hidhur, ky është realiteti i krijuar nga vetë njerezit e këtij realiteti, por që me të identifikohesh edhe ti te cilin nuk mund ta ndryshosh lehtë, sado që të përpjekesh, qoftë edhe me përpjekje të medha. Realiteti që jetojmë është një oqean i tërë dhe ti je një njeri i mirë që me një lugë në dorë heq 'ujë' në këtë oqean. Çdo ditë me lugën tënde heq një dhe çdo ditë vëren se asgjë nuk ka ndryshuar nga niveli i ujit në oqean. Duam s'duam ky është realiteti, ai islam dhe ai joislam... Muslimanët sot janë në një fazë tranzicioni që po zgjat pamasë. Sot, muslimanët vuajnë mungesën e liderëve, vuajnë mungesën e arsimimit, të zellit për punë, të maturisë dhe edukimit të duhur. Me gjysmë zëri e them, por muslimanët sot vuajnë nga shumë gjëra... Duke u përpjekur që të jemi aktuale dhe ta kuptojmë qartë realitetin, vërejmë se muslimanët (në përgjithësi) lexojnë pak librin fetar, ate historik dhe artistik duke harxhuar shume kohe për internet, kafene dhe për ekran të televizorit ku vlerat janë të pakta dhe shume të kufizuara. Duke bërë ecejake pa doreza në realitetin tonë, vërejmë se shume muslimane janë të dobët ekonomikisht. Kjo nuk vjen vetëm si pasojë se ata nuk duan të përlyhen me haramin, por ngaqë synimet e tyre janë modeste dhe jo te një niveli të lartë. Na ka rastisur një herë të dëgjojmë bisedën e disa të rinjve në një xhami të qytetit, ku po bisedohej për problemet e arsimimit të tyre. Na habit fakti se asnjeri nga ata të rinj nuk ndiqte fakultete, por pretendonin të ndiqnin kurse profesionale të cilat pasohen nga një formim mesatar në jete në të gjithë treguesit. Zoti i Madhërisë u ka dhënë këtyre të rinjve vlera fizike dhe mendore, por këta të rinj nuk pretendojnë për të kapur piketa të larta me keto vlera të mrekullueshme që i kanë dhuruar nga Allahu xh.sh., sepse rinia islame duhet të dalë nga orbita për të qene e qeverisur duke bere përpjekje të jete pjese e orbites që qeverise. Fatkeqësisht ky është një realitet i muslimanëve në trevat shqiptare dhe në shume vende të botes islame, por pa

mohuar edhe dijetare dhe njerëz të shkencës në rrallet emuslimaneve të cilët është në dobi të islamit që të jenë me të shumtë në numër dhe që është obligim që ata të japin një ndihmë të madhe në ecjen e islamit përparë dhe në rritjen e prestigjit të tij në të gjitha hapësirat ku ata jetojnë. Muslimanet nuk mund të qëndrojnë sot të lidhur me xhaminë, vetëm me namazin., por duhet të jenë të lidhur edhe një sërë gjërash të tjera, si: Ligjërata, aktivitete të ndryshme me xhematin, biseda në grup, etj. Këto sot nuk realizohen në masë të gjerë, duke sjelle ftohjen e besimtareve nga xhamia, degradimin e imanit të tyre dhe në fund largimin e tyre edhe nga xhamia. Duhet të kemi të qartë se, nëse këtyre të rinjve nuk ua zëmë kohën me aktivitete të hajrit dhe të dobishme, nëse këta nuk i mbajmë afër, qarqet të ndryshme janë gati t'ua zënë kohën dhe t'i gllabërojnë nëpërmjet ofertës së tyre për dëfrim, por që realisht është ofertë për degjenerim. Na qëllon një natë Ramazani të kalonim pranë një bilardoje, brenda së cilës shikova një djalosh që para pak muajsh kishte qenë në xhami pjesë e xhematit të saj. Ezani po thirrej dhe ai vazhdonte të luante perseri. Mendojme se ky rast është një pjesë nga kontingjenti që është larguar nga ambjete të xhamisë për "fajin e xhamisë" të cilin e trajtoam në fillim të këtij shkrimi. Xhamitë dhe prijësit fetarë duhet të kenë një strategji të mirëfilltë dhe shumë teknike, në mënyrë që të jenë tërësisht në shërbim të xhematit me çdo gjë që i nevojitet atij dhe ta mbajë të lidhur atë me shtëpinë e Zotit. Koha që jetojmë sot e kërkon një gjë të tillë dhe askush s'duhet të ketë kurajën e të thotë se namazet dhe një ligjëratë në jave janë të mjaftueshme. Sot, të rinjve muslimanë u janë ngritur kurthe dhe sfida të rrezikshme në çdo hap që hedhin dhe është vënë në rrezik të qenurit musliman. Ndërsa ligjëratat mbahen për 'marginet e avdesit mbi meste', kur bën e kur s'bën. Sa ditë të mbahen mestet veshur e të tjera si këto. Te mos harrojmë se në xhamia të ndryshme të fshatrave, ndodh që të mos falet namazi i xhumasë, sepse nuk ka se kush të prijë në namaz e të mbajë hutben. Në një kohë kur, në një xhami të qytetit, mbledhen sëbashku për t'ua falur si xhemat 4-5 hoxhallarë. Xhamitë mbyllen se s'ka kush t'i drejtojë si imam në një kohe që edhe ata imame që mbajnë xhamitë

hapur kanë një rrugë me të ulet se pensioni i një qytetari.

Problemi i muslimanëve sot është vetja e tyre, sepse u mungon një strategji e cila duhet të ketë në bazën e saj bashkëpunimin dhe jo përjashtimin në emer të bidateve, selefizmit, vehabizmit, hanefizmit, ku injoranca penalizon dijen fetare dhe vete xhematin e xhamiave, penalizim që shtrihet edhe tek të gjithë muslimanet e tjere. Na ka bërë përshtypje një deklaratë që u bë nga disa hoxhallarë shqiptarë (rreth 62 vetë), e cila u përhap në forma të ndryshme, yahoo-grupe, website dhe emailie, në të cilën hoxhallarët tanë zotoheshin që: 'Të mos bashkëpunonin me shiitët, në as edhe një mënyrë!' Ndoshta me të drejtë pyes: Problemi i muslimanëve shqiptarë sot janë shiitët e Iranit dhe ato 10-20 shiitë që janë në Shqipëri, që në fund të fundit thonë 'Zoti ynë është All-llahu'; apo problemi i muslimanëve shqiptarë sot janë ata që përpiqen natë e ditë ta shkatërojnë Islamin, që thonë se 'Zoti ynë s'është All-llahu', por është 'X-si' dhe 'Y-i'. A janë sot problem 10 shiitë, apo ato organe që po ndalojnë në nënat, gratë dhe motrat tona të mbajnë mbulesë në universitete, institucione shtetërore, etj? A janë problem 10 shiitë, apo janë problem për ne ato që po gllabërojnë, si pasojë e heshtjes dhe e injorancës sonë, pronat e vakëfit islam, të cilat i lanë amanet për ne paraardhësit tanë...? A janë problem 10 shiitë, apo të tjerët që po mbushin sheshet publike me buste dhe emërtime të njerëzve 'publike' që janë përfaqësues të tyre dhe të përkatësisë së tyre fetare; kush është problem?!... A s'janë problem ato që po përpiqen të na kthejnë në të pafé, apo janë problem 10 shiitë që në fund thonë: 'Unë jam musliman!' Të gjithë intelektualët muslimanë, të gjithë hoxhallarët, sikur të bashkoheshin në formimin dhe hartimin e një reviste, gazete, apo organi shtypi të mirëfilltë, do të ishte mjaft mirë; sepse në sot vuajmë mungesën e një organi të tillë që të shpërndahej në të gjitha trevat shqiptare, që të krenohemi me të, për cilësinë dhe për mesazhin që percjell

Medojmë se nga kjo gjendje mund të dilet duke besuar në aftësitë tona, duke mos u pajtuar me realitetin e hidhur, por duke tentuar që ta ndryshojmë atë me punë dhe përpjekje. Nga kjo situatë mund të dalim atëherë, kur ta kuptojmë tamam is-

lamini si fe, kulturë dhe qytetërim, kur fati i muslimanëve të jetë fati ynë, kur problemet dhe hallet e tyre të shndërrohen në problemet dhe hallet tona, thënë ndryshe, të jetojmë me to...

Në do të dalim nga kjo gjendje, duke u arsimuar në nivele të larta, për t'u ngritur në aspektin intelektual. Vetëm atëherë kemi investuar për mirë, gje që do të jete një ogur shpresedhenes, për të ndryshuar realitetin e gjendjen tonë në të cilën jemi sot. Të paturit e idealeve, objektivave dhe qëllimeve të larta, për të arritur nesër më shumë se sot, do të thotë se ti je në rrugë të mbarë dhe shumë shpejt e ardhmja do të jetë jotja si musliman i mirë. Nga kjo situatë mund të dilet vetëm duke i thënë njëri-tjetrit: 'Ti je vëllai im dhe unë jam vëllai yt dhe duke iu rikthyer traditës profetike dhe fjalës së All-llahut të Madhëruar, sepse All-llahu i Plotfuqishëm me Kur'anin lartëson dhe poshtëron popuj...

Në një hadith madhështor për Kur'anin, Muhamedi (a.s) thotë:

'Do të ndodhin sprova e bela! Mirëpo, cila është rrugëdalja?

Libri i Zotit... Në të është lajmi i atyre që ishin para jush. Ai e ndan drejt dhe nuk bën shaka... Kush e lë Kur'anin nga frika e ndonjë tirani, Zoti e këput në mes!

Kush kërkon drejtim diku tjetër, Zoti e humbet! Ai është litari i fortë i Zotit, është fjala e urtë, është rruga e drejtë.

Me të nuk përzihen qejfet, nuk ngatërrohet gjuha, nuk ngopen dijetarët. Ai nuk vjetrohët edhe kur lexohet shumë, nuk i mbarojnë çuditë...

Kush flet me të, thotë të vërtetën.

Kush gjykon me të, gjykon drejtë.

Kush punon me të shpërblehet.

Kush fton tek ai, ka ftuar për në rrugën e drejtë!...

Zoti na e ndriçoftë mendjen, na dhashtë urtësi, dituri e kurajë për të reaguar! Ai e përmirësoftë gjendjen tonë, duke u bërë në sebeb për përmirësim! Amin!

Mirsad Sylja

PERSERI TURQIA NE MBROJTJE TE BOTES ISLAME

Samiti i fundit i Organizates se Atlantikut Verior, ose si njihet ndryshe NATO, aprovoi pranimin e Kroacise dhe te Shqiperise ne rrallet e kesaj organizate ne kuadrin e zgjerimit te saj, si pjese strategjise per te rrite dhe forcuar kapacitetet e saj ne linje me strategjite e saj afatshkurtera dhe afatgjata. Por, ne programin e ketij takimi, NATO kishte parashikuar edhe zgjedhjen e sekretarit te ri te kesaj organizate ushtarake, sepse po mbaronte afati i sekretarit aktual te saj. Dhe sekretari i ri i propozuar ishte ish-kryeministri danez, Rasmundsen. Duket se te gjithë delegacionet e kishin pranuar de fakto sekretarin e ri, por duhej qe ai te pranohej edhe de jure permes nje pranimi unanim. Ketu filloi ajo qe u quajt krize ne gjirin e Natos per te pranuar per sekretar Rasmundsenin. Fjala ishte per refuzimin e ashper qe i beri kryeministri turk, Taip Rexhep Erdogan kandidatues se Rasmundsenit per sekretar te Natos. Motivin perse po refuzohej sekretari i ri i organizates se Atlantikut Verior, kryeministri i Turqise do ta lidhte me qendrimin e ish-kryeministrit danez ndaj botimit te karikatave kunder Profetit, Muhamedit a.s. nga nje gazete daneze te cilat u ribotuan nga gazetate me te medha evropiane per te shprehur ne nje shkalle edhe me te larte

urrejtjen ndaj Profetit te fese islame, veprime dhe prononcime mediatike qe u bene ne emer te lirise se shtypit, por qe kishin nje prapavije te nje urrejtjeje te thelle fetare kunder fese islame dhe muslimaneve. Politikani Rasmundsen, atehere kryeminister i Danimarkes, nuk i denoi keto karikatura qe tensiononin maredhenjet e Perendimit me Lindjen Muslimane, por e mbrojti botimin e tyre si vlere e lirive demokratike qe posedon sot Perendimi i qeteteruar, duke harruar qellimisht se po shkelte me kembe mbi vlerat shpirtore te 1,5 miliard muslimaneve qe jetojne ne te gjithë kontinentet. Kryeministri Erdogan i beri nje portret realist Rasmundsenit duke deklaruar se ai nuk mund t'i sherbeje paqes boterore, sepse ishte opozitar me 1,5 miliard muslimane dhe se ne nje pozicion udheheqes ne NATO, eshte i papranueshem nga Turqia. Reagimi ne Nato ishte i shpejte, i ashper, por edhe i shqetesuar. Disa perfaqesues te ketij samiti e kercenuan Turqine se me kete qendrim do te veshtiresonte pranimin e saj ne BE (qe edhe pa kete qendrim ata nuk po e pranojne). Delegacione te tjera bene perpjekje te jashtezakonshme qe te zbuten qendrimin e Turqise ndaj vendimit per te vene Rasmundsenin sekretar te pergjithshem te Natos. Ishte kryeministri italian, Berluskoni, dhe presidenti amerikan, Obama, qe i propo-

zuan kompromisin Turqise, duke emeruar nje perfaqesues te saj ne postin e z\ vendes sekretarit te pergjithshem te Organizates se Atlantikut Verior. Ky qendrim i Turqise tregon se ne patem te drejte kur e quajtem "nje rreze drite per boten islame" qendrimin e kryeministrit turk ne Davos te Zvicres, kur e akuzoi Presidentin e izraelit se shteti izraelit eshte nje shtet vrasesish. Tashme per muslimanet ne te gjithë boten eshte bere e qarte se qendra qe mbron sot politikisht islamin nga sulmet dhe denigrimet nuk eshte nje person, ose nje shoqate joqeveritare, por eshte Turqia, nje shtet me potencia te fuqishme politike ekonomike dhe ushtarake, qendrimi i se ciles i ka bere kundersharet e fese islame qe te mendohen para se te penalizojne muslimanet dhe fene islame. Muslimanet e kane kuptuar se tashme e kane ne menyre te figurshme Kalifatin e tyre politik, i cili eshte faza e pare e rendesishme per te ngrite ne te ardhmen Kalifatin e mirefillte islam, ku kandidon e vetme Turqia e cila e ka obligim qe te realizoje amanetin per te vendosur serisht Kalifatin Islam pikerisht aty ku edhe e rrezuan armiqte historike te fese islame.

Selim Gokaj

XHUMAJA E GJENERALI GJERMAN

27 mars 2009. Ditë e premte. Komandanti i Brigadës Shumëkombëshe, gjenerali gjerman, Fuger, se bashku me dy eprorëve të lartë të tij dhe të përkthyesit të tij, i shoqëruar nga nikoqiri i tij, Ali ef. Vezaj, kryeimam i Bashkësisë Islame në Prizren, mori pjesë në namazin e xhumasë, që nga fillimi e gjer në fund, në xhaminë qendrore të Prizrenit, Gazi Mehmed Pashës, apo Bajraklisë, siç njihet në popull, xhami në të cilën u mbajt edhe Kuvendi i Lidhjes së Prizrenit, më 10 qershor 1878. Pikërisht në 10 vjetorin e shënimit të bombardimeve të NATO-së mbi caqet ushtarake serbe, prezenca e tij në namazin e xhumasë ishte e një rëndësie të veçantë. Gjatë 10 vjetëve të kaluara, shumë gjenerale e kanë vizituar Bashkësinë Islame të Prizrenit, apo Vakëfin e Prizrenit që njihet në popull, si dhe xhaminë e Bajraklisë. Por, është hera e parë që një gjeneral, pikërisht ai gjerman, Fuger, të jetë prezent në mesin e besimtarëve myslimane gjatë faljes së për-bashkët javore të namazit të xhumasë. Në ligjëratën javore të xhumasë (hytbe), përveç

tjerash, imami i xhamisë së Bajraklisë, Reshat ef. Mexhid, falënderoi prezencën e gjeneralit gjerman, Fuger në mesin e besimtarëve myslimane në namazin e xhumasë, si dhe ndihmën dhe kontributin e Aleancës Veriatlantike para 10 vjetëve në Kosovë, për shpëtimin dhe parandalimin e zhbërjes së popullit shqiptar, veprim që buron nga humanizmi moral, njerëzor, shoqëror dhe civilizues, pasi e tërë shoqëria njerëzore rrjedh nga një babë e nga një nanë, Ademit dhe Havasë dhe se të gjithë besojmë në një Krijues të vetëm, në Allahun e Madhëruar, pa harruar se secili i lutet Zotit sipas fese se ciles i perket në xhami, kishë apo sinagogë. Pas faljes së namazit të xhumasë, në bashkëbisedim me gjeneralin gjerman, Fuger, ai theksoi se qëllimi i vizitës dhe prezencës së tij në namazin e xhumasë ishte që të njihet së afërmi me mënyrën e faljes dhe lutjes së besimtarëve myslimane të namazit të xhumasë. Me të vërtetë ishte tejet i kënaqur dhe me emocione të veçanta dhe se përsh-typje i kishte lënë procedura e faljes dhe atmosfera që ishte brenda xhamisë gjatë namazit të xhumasë. E falënderova gjeneralin

gjerman, Fuger, duke i thënë se ishte nder dhe kënaqësi e veçantë prezenca e juaj gjatë namazit të xhumasë dhe me kete vizite i keni nderuar besimtarët dhe se i keni bërë nderë edhe xhamisë kryesore të Prizrenit, asaj të Bajraklisë. Ishte ky një shembull i mirë nga i cili do të duhet të marrin mësim liderët tanë politike, institucionale, shtetërore shqiptare myslimane në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni, të cilët sot, jo që nuk marrin pjesë dhe asistojnë në namazin obligativ javor të xhumasë, por as në namazet vjetore, atë të dy Bajrameve, përveç disa përjashtimeve të vogla të cilat mund të numërohen në gishta.

Përfaqësuesit myslimane te popullit shqiptar të cilët nuk e respektojnë dhe zbatojnë besimin, fenë dhe kulturën, të cilës i përka-sin, per habine tone tregojnë respekt ndaj besimeve dhe kulturave tjera per te cilen edhe ne nuk jemi kunder por jo te neperkembet feja e tyre islame nga ata vete.

Faik Miftari

Materjali eshte derguar per gazeten "Besimtari"

KONFERENCA E VENDEVE ISLAMIKE MIKE E MADHE E SHQIPTAREVE

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ مُحَمَّدٌ رَسُوْلُهُ



Te gjitha mediat nderkombetare dhe ata kombetare bejne te ditur se ne samitin e fundit te Konferencës islamike eshte aprovuar rezoluta e paraqitur nga Turqia, Arabia Saudite dhe Shqiperia e cila e njeh Pavaresine e Kosoves. Duket se vendet muslimane e kane anashkaluar qendrimin poshterues te politikës shqiptare ndaj ketij organizmi qe eshte organi me i larte qe perfaqeson muslimanet ne shkalle boterore Ky qendrim i politikës se majte shqiptare u manifestua dhe u mbajt gjalle shume vite pas anetaresimit te Shqiperise si pjese e kesaj organizate nga ish- president i viteve 1992, Sali Berisha, i cili sa nuk "U var ne mes te Tiranes" nga politika e socialisteve dhe e nje lukunie analistesh dhe mediash servile dhe antishqiptare qe operojne ne Shqiperi me nje larmi prapavijash te rrezikshme antimuslimane dhe antikombetare. Jane keto media qe i mbushen faqet e gazetave dhe programet e radios me akuzat dhe penalizime te poshtera kunder Sali Berishes dhe qeverise Demokratike qe e beri Shqiperine pjese te Konferencës se Vendeve islamike. Politika e majte dhe mediat

e tyre te rrezikshme e dine se Sali Berisha eshte musliman me emer, sepse nuk eshte pare kurre ne keto 20 vjet demokraci duke hyre ne nje xhami, ne nje kohe qe shume here ka qene pjesemarres ne ceremoni kishtarë per te cilen as qe eshte folur ndonje here. Politika e majte dhe median qe ajo ndersen kundra Sali Berishen ka ne shnjester Boten Islame dhe muslimanet shqiptare qe jane pjese e botes islame, sepse muslimanet jane vellezer perpare se te flitet se ku banojne. Mediat shqiptare flasin per nje triumf te politikës shqiptare ne njohjen e Kosoves. Por ata harrojne se per diplomacine shqiptare njohja e Pavaresise se Kosoves do te ishte vonuar shume, sepse vendet muslimane e njohin te verteten per poziten e muslimaneve ne Shqiperi te cileve nuk u japin te drejten te ndertojne nje xhami ne Tirane, por i detyrojne muslimanet te falen ne mes te shiut. Nuk i lenë te mbajne shamia dhe mjekra qe jane detyrime fetare per nje musliman.

Vendet muslimane e aprovuan rezoluten per Pavaresine e Kosoves, sepse kosovaret jane te perkatesise muslimane 90% dhe fetarisht ata jane vellezer me popujt e Konferencës se Vendeve Islamike.

Dite e nate ne Shqiperi mediat dhe politikanet e ngrejne zerin ne qiell se Shqiperia i takon Evropes, me qellim qe t'i shkepusin shqiptaret nga lidhjet e fuqishme kulturore dhe fetare me Lindjen muslimane dhe ata te mesohen me kete slogan qe nuk i sherben interesa kombetare te shqiptareve. Dhe kjo behet per hir te nje servilizmi te rendomte perfitues, duke mohuar identitetin e vertete te shumices se popullit shqiptar.

Greqia, Rumania, Sllovakia, Spanja vazhdojne te mos e njohin Pavaresine e Kosoves.

Te mos harrojme se ne Bosnje nje brigade me vullnetare greke ishte pjese e masakrave kunder muslimaneve boshnjake, sidomas ne Srebernice. Vullnetare nga Rumania ishin me shumice pjese e masakrave ne Bosnje dhe ishin keto rumune qe, duke qene police te Unmikut, vrane demonstruesit kosovare qe demonstruan kunder vrasjes se femijve te tyre nga serbet ne Mitrovice. Ne nje linje te tille historike antimuslimane eshte edhe Spanja Sllovakia dhe shteti tjetër qe ploteson numurin 5 te vendeve evropjane qe jane kunder Pavaresise se Kosoves. Sot medi-

at shqiptare e kishin lajm te pare aprovimin e rezulutes per kosoven nga Konferenca e vendeve Islamike. Nuk e dime se ku do te jene strehuar politikanet ekstremiste antimuslimane si Nano, Blushi Gjinushi e shume te tjere qe u bene te semure duke bertitur kunder Konferencës se Vendeve Islamike. Tashme te gjithë shqiptaret e kane marre vesh se popujt muslimane jane miq te medhej dhe pa interes e shqiptareve dhe rezoluta e eksaj Konferencës te vendeve muslimane eshte vendim jetik per ecjen esigurate te Kosoves drej perparimit pavaresisht se kryeministri i Kosoves Hashim Thaci nuk pati gucim t'i citoje me emra vendet muslimane por foli me peremra gjate prononcimit per rezolutene Konferencës se Vendeve Islamike per Kosoven.

Kuptohet s'erezoluta nuk u aprovua per kontributin e thacit dhe te Sejdiut per forcimin e mardhenjeve te vendeve muslimane me Kosoven por u aprovua si detyrim moral -fetar i ketyre vendeve per popullin nella musliman te Kosoves

Selim Gokaj

PAPA KERKON BASHKEPUNIM ME BOTEN ISLAME

Media bëjnë të ditur se Papa, Benediku i 16, sapo ka filluar një vizitë në Lindjen e Mesme në përpjekje për të dhënë ndihmesën e tij në uljen e tensioneve në këtë rajon, ku hijet e luftës janë prezente dhe shumë të rrezikshme. Ndalesën e parë Papa e bëri në Jemen, ku vizitoi xhaminë më të madh në vend duke bërë thirrje për tolerance fetare dhe bashkëjetesë fetare. Thirrja e tij është pjesë e politikës që po ndjek sot Perëndimi ndaj botës islame e cila është tepër e revoltuar dhe

armiqësore me Perëndimin për politikën e tij të hapura kundër islamit që fillojnë nga 11 shtatori dhe pastaj vazhdojnë me Guantanamo, karikaturat kundër Profetit a.s. dhe me vetë deklaratat e Papës kundër muslimanëve në një simpozium në Gjermani në vitin 2006. Papa tha se të krishterët e ndjejnë vehten të cënuar në këtë hapësirë dhe se feja nuk duhet të përdoret nga politika, sepse atëherë misioni i fesë është i cënuar. Por, e vërteta është se pikërisht veprimet që bëhen sot kundër muslimanëve, që nga provokimet dhe vrasjet e tyre, kanë prapavijë fetare, sepse Guan-

tanamo, Abu Garib dhe burgjet sekrete të Cias u bënë hapësira ku muslimanët u torturuan dhe u përdhunuan vetën se ishin muslimanë dhe është vetë drejtësia e botës Perëndimore që u detyrua të ndërhyjë dhe të denojë fajtorët për krime që arritën të përdhunonin dhe të shfarosnin familje të tëra. Ka ardhë koha që përpara se të kërkohet bashkëpunim me botën islame, duhet të kërkohet falje për krime dhe për përpjekjet që janë bërë dhe bëhen për të barazuar viktimën me vrasësit. Qëndrime të tilla janë pare gjatë luftës në Bosnje, Kosovë Palestinë, gjë që

u ka krijuar mundësi vrasësve të dalin "Pak të lagur" nga gjykatat ndërkombëtare. Prandaj thirrja "U bëjnë thirrje palëve të ulin armët dhe të vetpërbahen" është fyerja më e rëndë që mund t'u bëhet viktimave muslimane. Mediat flasin edhe për vizita të Papës në Izrael dhe në Palestinë. Të shohim sa do t'i ndigjohet zëri i Papës nga shteti hebre që nuk përfilli as vendimet e OKB për të ndaluar sulmet e tyre vdekjeprurëse mbi civilët në Gaza.

Vëzhguesi

NE IZRAEL KONTESTOHET VIZITA E PAPES

Në një informacion të dhënë në një nga emisionet esaj, Radio Tirana bën të ditur se partia ultraortodokse, Shaz ka bojkotuar parlamentin izraelit në shenjë proteste për vizitën e papa Benedikut XVI në parlamentin izraelit.

Bojkoti ka të bëjë me të kaluarën e papa Benedikut të XVI i cili, sipas kësaj partie, ka qenë pjesë e rinisë hitleriane.

Ultranacionalistët izraelitë deklaruan se ata e kontestuan vizitën e papës në shenjë respekti dhe nderimi për viktimat e holokaustit, ku miliona hebrenj u shfarosën në kampet naziste

gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjithashtu, papa është i kontestuar në Izrael edhe për një fakt tjetër që ka të bëjë me një herark të lartë të kishës katolike i cili është shprehur kundër parametrave me të cilat i serviret sot holokausti opinjonit publik botëror, duke vënë në dyshim të vërtetën e këtyre parametra.

Ajo që i ka shqetësuar izraelitët ka qenë qëndrimi tolerant i Papa Benedikut XVI ndaj këtij herarku të lartë të kishës katolike që me deklaratat e tij është kundërvënë holokaustit.

Informacion mediatik

SHTETI IZRAELIT AKUZOHET NE GJENEVE PER RACIZEM

Në konferencën ndërkombëtare kundër racizmit, që është mbajtur në Gjenevë të Zvicrës, kanë marrë pjesë shumë shtete nga e gjithë bota të cilët në fund të këtij samiti të rëndësishëm, përmes një deklarate, dënuan racizmin si një dukuri e cila cënon të drejtat dhe liritë e njeriut dhe njëkohësisht është edhe një dukuri e saktë e një genoci që zhvillohet kundër individëve të vaçantë, ose popul-

latave të caktuara të një shteti. Ra në sy mungesa e delegacionit nga SHBA, Kanadaja, Australia të cilët, me këtë qëndrim nuk i dhanë pikët e mundshme që duhet të marrë një samit i tillë kaq i rëndësishëm. Por, konferenca kundër racizmit, që u mbajt në Gjenevë të Zvicrës, pati edhe "incidentin" e saj, i cili ka të bëjë me qëndrimin që mbajti presidenti i Iranit, Ahmadinexhat, i cili, në fjalën e tij, e cilësoi shtetin Izraelit si shtet racist duke u kujtuar të pranishmëve pushimin e Palestinës dhe dëbimin

e milionave palestinezëve nga vatrat e tyre, pa harruar edhe një genocid sistematik kundër popullsisë së pambrojtur, siç ndodhi kohët e fundit me sulmin pa precedent mbi Gaza. Por, akuzat e presidentit iranian sollën reagimin e delegacioneve që ishin në salla. Një pjesë e tyre, në shenjë proteste, u larguan nga salla. Kur presidenti iranian u kthye në atdhe, ai u prit si hero në aeroportin e Teheranit për sulmet që kishte bërë në Gjenevë kundër shtetit izraelit. Por, sulmet kundër Izra-

elit, presidenti iranian i vazhdoi edhe në një konferencë shtypi në prezencën e shumë gazetarëve, ku e akuzoi Izraelin edhe për spastrim etnik në Palestinë. Në një reagim të tij për deklaratat e presidentit iranian, presidenti amerikan, Obama, tha se nuk ishte i befashuar, sepse këtu nuk ka azgjë të re nga sa është thenë më parë nga Ahmadinexhat.

Informacion mediatik

MEMORIAL NE SARAJEVE PER FEMIJET E VRARE NGA SERBET

Bëhet e ditur se në Sarajeve u zbulua me datën 12 maj 2009 pllaka përkujtimore e momerialit që i kushtohet 1500 femijve të vrarë në luftën që u zhvillua në Bosnje ne vitet 1992-1995 nga armata e ish- Jugosllavisë dhe nga paramilitarët serbe. Këtyre krime të rënda u duhen shtuar edhe 10 mijë qytetarëve të tjerë të Sarajevës që humbën jetën nga bombardimet e pameshirshme serbe që nuk kursyen as civilët e Sarajevës që mbushnin ujë dhe blinin në treg ushqimet për të mbijetuar. Ky memorial është një përkujtim dhe nderim për viktimat e luftës në Bosnje, ku boshnjakët u vranë dhe u përdhunuan vetëm se përkatësia e tyre ishte muslimane Memoriali i fëmijve të vrarë në Sarajevë është edhe një akuzë e ashpër për bashkësinë ndërkombëtare që i la bashnjakët muslimanë të paarmatosur në mëshirën e serbëve, sepse ndaj muslimanëve në Bosnje u zbatua ajo që quhet turpi i bashkësisë ndërkombëtare , embargoja e armëve për muslimanët e Bosnjës. Sot, po të hapësh një grope në Bosnje, do të zbulosh një kufomë muslimani ,ose një grumbull kufomash muslimanësh. Këto janë pasojat e menaxhimit që "Të Mëd-



henjtë" i bënë luftës së Bosnje, ku u dalluan sidomos francezet dhe anglezët, pa përmendur edhe shumë të tjerë edhe "më të Mëdhenj" se këta që i lejuan masakrat kundër muslimanëve në Bosnjë. Sot, në Bosnje nuk vriten më fëmijë. Por, në botë vazhdon vrasja e fëmijëve muslimanë. Palestina, Afganistani , Iraku dhe shumë hapësira të tjera muslimane janë sot vende ku bombat dhe plumbat vrasin fëmijë muslimanë të pafajshëm. Dhe

vrasësit ua ngarkojnë fajin avionëve dhe aviatorëve, teknologjisë që nuk funksionon saktë në terren. Por, e vërteta është së vrasja e fëmijve ne Bosnje në vitet 1992-1995 dhe vrasja e femijëve sot në Afganistan dhe në Palestinë janë pjesë e të njëjtës strategji që funksionon kundër muslimanëve. Memoriali për fëmijët muslimanë të vrarë në Sarajeve është edhe një thirrje për t'i thenë fund vrasjes dhe krimeve kundër muslimanëve. presidenti

Obama, Papa, dhe misionarë të tjerë të Perëndimit po bëjnë thirrje dhe po kërkojnë bashkëpunim me Botën islame. Urojmë që këto lëvizje politike të jenë të sinqerta dhe në shërbim të një bashkëjese reale fetare në botë.

Selim Gokaj


KARAXHIC MBROHEJ ME STATUS NDERKOMBETAR NGA ARRESTIMI

Mediat vizive dhe te shkruara bejne te ditur se udheheqesi politik i serbeve te Bosnjes, qe po gjykohet ne Hage per krime lufte kunder njerezimit, me saktesisht per vrasjen mizore te 11000 muslimaneve boshnjake ne Srebernice, Radovan Karaxhic, ka kerkuar nga Gjykata e Hages qe te pushoje gjykimin ndaj tij dhe te terheqe akuzat ndaj tij, sepse i eshte premtuar nga diplomati amerikan Hollbruk, ne vitin 1996, se ndaj tij do te terhiqeshin akuzat per krime lufte, me kusht qe Karaxhic te terhiqej nga politika. E verteta

eshte se po keto deklarata udheheqesi i serbeve te Bosnjes i beri sapo u arrestua dhe u dergua per t'u gjykuar ne Gjykaten e Hages, duke e quajtur nje premje ne bese arrestimin e tij. Por, diplomati amerikan, Hollbruk, e ka mohuar nje akuze te tille duke e quajtur ate shpifje per t'i shpetuar Gjykates se Hages nga kriminelin Karaxhic. Megjithate, koha teper e gjate deri ne arrestimin e tij, te le te kuptosh se duhet te kete qene nje prapaskene diplomatike dhe politike ajo qe vonoi arrestimin dhe daljen para drejtesise te Karaxhicit, gje qe e pat revoltuar opinionin publik dhe ne menyre te vecante muslimanet e Bosnjes

te cilet e kane penalizuar faktorin nderkombetar per njeanshmeri ne trajtimin e konfliktit etnik-fetar ku viktimat muslimane u barazuan me genocidin serb ndaj tyre. Te shohim si do te perfundoje Karaxhic ne Hage dhe ne se edhe ky deshmitar i rrezikshem per nderkombetaret ,qe u implikuar ne tragjedine qe pesuan muslimanet ne Bosnje, do te kete fatin e eprorit te tij politik, ideplogjk, dhe ushtarak, Sllobodan Milloshevic.

Bledar Dani



Space-center

Qendra e internetit space-center ju ofron:

- internet te shpejte,
- shperndarje interneti,
- programe te ndryshme,
- cd, dvd, mp3,
- servis kompjuterash
- printime, skanime, etj.

Te gjitha keto me nje sherbim cilesor e te kulturuar.
Jemi hapur cdo dite nga ora 08:00 deri 23:30.

Adresa: pallati xhenis pas rektoratit te universitetit
"luigj gurakuqi", kati I

Kontakte:

- e-mail: spacecenter@live.com
- Cel. 0693253723 / 0672944162

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
 BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIME
 Tregtojme
MISH HALLALL
 E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

Produkt Hallall

**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:
sallam, suxhuk etj.**

2- Piceri hallall

3- Fast Food hallall

**Ju keni te drejte te blini ku te doni
por hallalli i vertete eshte vetem
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"
Cel: 0692101893